



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2022

V E N D I M

Nr. 13, datë 11.01.2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 129, datë 16.07.2021, të z. D.B., përfaqësuar nga Av. I.D., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjes politike*” nga ana e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit².

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të dhënë në ankesë, z. D.B. është emëruar nëpërmjet aktit nr. 1837 prot., datë 15.05.2020, të Kryeinspektorit të IKMT, në detyrën e specialistit (inspektor), në Sektorin e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujrave, në Drejtorinë Rajonale Dibër, të IKMT-së. Marrëdhënia e punës rregullohej nëpërmjet Kontratës Individuale të Punës me afat të caktuar (3 mujor), përgjatë periudhës 20.05.2020-20.08.2020. Në vijim, nëpërmjet shkresës nr. 2971 prot., datë 08.07.2020, të Kryeinspektorit të IKMT-së, z. D.B. lirohet nga detyra, me motivacion moskryerje të detyrave pa shkaqe të arsyeshme. Ankuesi sqaron se në datën 27.06.2020 (ditë e shtunë) ka qenë në detyrë, si dhe ka marrë pjesë në takim in e realizuar nga Ministri i Brendshëm në Bulqizë, takim në të cilin ka qenë e pranishme edhe Kryeinspektorja e IKMT-së. Në datën 29.06.2020 (ditë e hënë), pas komunikimit paraprak me Përgjegjësën e Sektorit

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD;

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën IKMT.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD;

ku punonte, z. Bici, e mori ditë pushimi. Një fakt i tillë është përdorur nga IKMT, si motivacion për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

Në ankesë sqarohet fakti se ankuesi në datën 27.06.2020 ka qenë në krye të detyrës dhe kjo mund të vërtetohet nga akt-kontrollet e kryera nga ai në lumin Mat-Suc dhe në Shkëmbin e Kuq-Suc. Në kushtet kur, Kodi i Punës është legjislacioni i aplikueshëm në këtë marrëdhënie pune, ai përcakton rastet kur punonjësi kryen orë shtesë, ai duhet të kompensohet me pushim ose pagë. Në këtë mënyrë, punëmarrësi ka marrë ditën e pushimit në datën 29.06.2020 për orët shtesë të kryera. Ankuesi sqaron se motivacioni i zgjidhjes së kontratës së punës nuk është i vërtetë dhe se i takonte IKMT-së që të përcaktonte në mënyrë eksplicite moskryerjen e detyrave nga ana e tij. Në interpretim të nenit 153 të Kodit të Punës, përcaktohet se dy janë kushtet kryesore dhe kumulative që duhen plotësuar në mënyrë që zgjidhja e menjëherëshme e kontratës të jetë e rregullt dhe e justifikuar, Së pari, është kushti subjektiv që lidhet me qëndrimin subjektiv, shkeljen e raportit të mirëbesimit ndaj punëdhënësit, por në çdo rast nuk duhet që rrethana të jetë abuzive dhe kushti objektiv, ku punëmarrësi duhet të ketë kryer një shkelje me faj të rëndë ose të lehtë në mënyrë të përsëritur dhe gjithmonë pas një lajmërimi. Njëkohësisht, në këtë kontekst, duhet të ketë edhe një lidhje shkakësore midis shkeljes dhe zgjidhjes së menjëherëshme të kontratës dhe shkelja të ketë cënuar raportin e mirëbesimit midis punëmarrësit dhe punëdhënësit. Ankuesi thekson faktin se ai është ekspozuar haptazi ndaj një trajtimi të paligjshëm dhe të padrejtë nga IKMT. Njëkohësisht, në ankesë sqarohet se referuar kontratës individuale të punës, në nenin 8 dhe 10, të saj parashikohen shkeljet disiplinore dhe masat respektive që mund të ndërmerren. Sigurisht që dhënia e këtyre masave është e rëndësishme, por pa harruar që në çdo rast dhënia e tyre duhet t'i nënshtrohet parimit të proporcionalitetit.

Për sa më sipër, ankuesi pretendon se lirimi nga detyra ka lidhje të drejtpërdrejtë me bindjet e tij politike të djathta, pasi ai është anëtar i Partisë Demokratike të Shqipërisë, vërtetuar kjo me anë të Kartës së Anëtarësisë nr. 190/210091, datë 24.04.2017, të lëshuar nga ky subjekt politik. Ankuesi pretendon se gjatë periudhës kohore, që ka punuar në Sektorin e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave, në Drejtorinë Rajonale Dibër, të IKMT-së, ai ka marrë pjesë në mbledhjet e kryesisë së kësaj force politike, si dhe shpeshherë është shfaqur në kronikat e edicionit të lajmeve në mbledhjet e kryesisë së kësaj force politike. Ankuesi sqaron se në bazë të ligjit nr. 9780, datë 17.07.2017 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme*", IKMT është një institucion buxhetor publik me statusin e personit juridik në varësi të ministrisë përgjegjëse për ruajtjen dhe sigurinë e territorit dhe ndërtimeve. Kryeinspektori, drejtuesi i institucionit, emërohet nga Kryeministri me propozim të ministrit përgjegjës. Kryeministri është Kryetari i Partisë Socialiste, i cili drejton Kabinetin e Ministrave, të cilët gjithashtu janë anëtarë të kësaj force politike. Ankuesi shprehet se Kryeinspektoria e IKMT-së ka kandiduar për deputete në listën e partisë Socialiste në zgjedhjet e 25 prillit 2021.

Ankuesi sqaron gjithashtu se zgjidhja e kontratës ka qenë *ultima ratio*, domethënë e menjëherëshme dhe për më tepër ka qenë e pajustificuar. Ankuesi, në asnjë moment, nuk ka kryer një shkelje të rëndë të përsëritur të detyrimeve kontraktore apo të atyre të parashikuara në legjislacionin në fuqi, përkundrazi të gjitha detyrat i ka kryer me korrektësi.

Në këtë kontekst, ankuesi pretendon diskriminim për shkak të bindjes politike nga ana e IKMT-së.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”⁴, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “*bindjes politike*”, duke përcaktuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Neni 7, i LMD, i ndryshuar, parashikon shprehimisht: “*1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.*”

⁴ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ky ligj në nenin 12, pika 1, gërmat a) dhe b) parashikon shprehimisht se: *“1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;”*

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 129, datë 16.07.2021, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7⁵, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua IKMT-së, me shkresën nr. 1038/2, datë 29.07.2021, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
 - Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesit;
 - Kopje e kontratës individuale të punës me afat të caktuar, aktit të emërimit në detyrë, si dhe aktit të lirimit nga detyra;
 - Prova dhe fakte, që vërtetojnë motivacionin e lirimit nga detyra;
 - Informacion mbi numrin e specialistëve (inspektorëve), në Sektorin e Inspektimit të Mjedisit dhe të Ujërave, në Drejtorinë Rajonale të IKMT-së, si dhe datat e emërimit të tyre;
 - Informacion mbi punonjës të tjerë të liruar nga detyra, pranë Drejtorisë Rajonale Dibër (IKMT), përgjatë vitit 2020 dhe 6 mujorit të parë të vitit 2021, si dhe motivacionet e largimit të tyre nga puna;
 - Informacion mbi punonjësin (kopje e dosjes personale), që ka zëvendësuar ankuesin.

⁵ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.*

- IKMT nuk i ktheu pergjigje shkresës së KMD.
- Në këto kushte, KMD iu drejtua sërish IKMT-së, nëpërmjet shkresës nr. 1083/3 prot., datë 01.09.2021, ku i bën kujtesë për kthim pergjigje.
- Në pergjigje të shkresës së sipërcituar të KMD-së, IKMT dërgoi shkresën nr. 3193/2, datë 03.09.2021, nëpërmjet së cilës bën me dije se ish punonjësi D.B. është larguar nga detyra bazuar në nenin 142, “Koha e provës”, të Kodit të Punës, me motivacion moskryerje të detyrave pa shkaqe të arsyeshme. Në shkresë sqarohet se mbështetur në Urdhërin e Kryeministrit nr. 22, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”, institucioni ka kaluar dy faza ristrukturimi dhe në këto kushte të gjithë punonjësit janë emëruar në bazë të shpalljes fitues nga grupi i vlerësimit dhe nuk mund të dilet dot në përfundimin, se kush e ka zëvendësuar ankuesin, sikurse është kërkuar nga KMD.

IKMT e bën me dije Komisionerin se z. D.K. dhe z. R.K. janë gjithashtu punonjës të larguar nga Drejtoria Rajonale Dibër.

Bashkëlidhur shkresës së sipërcituar janë dërguar edhe kopje të akteve të emërimit dhe lirimit nga detyra të ankuesit.

- Në vijim të procedurave hetimore, nëpërmjet shkresës nr. 1313 prot., datë 20.09.2021, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 14.10.2021, ora 11:00, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore mori pjesë ankuesi dhe përfaqësuesja e tij ligjore, av. I.D. IKMT nuk dërgoi përfaqësues për të marrë pjesë në seancë dëgjimore, ndaj kjo seancë u zhvillua në mungesë të këtij institucioni.

Subjekti ankues parashtroi edhe njëherë pretendimet e tij, për diskriminim për shkak të bindjes së tij politike. Përfaqësuesja e tij ligjore theksoi faktin se z. D.B. është punësuar, në bazë të një kontrate me afat të caktuar dhe është larguar nga detyra me motivacion “*mospërmbyshje e detyrave*”. Largimi i z. D.B. ka ndodhur gjatë periudhës 3 (tre) mujore të provës dhe shkak i largimit është i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me pjesëmarrjen aktive të ankuesit në strukturat e Partisë Demokratike Bulqizë. Av. I.D. sqaroi se ankuesi është anëtar i hershëm i subjektit politik “Partia Demokratike”. Në datën 30.06.2020, ai ka marrë pjesë në një takim të këtij subjekti politik, takim ky që është bërë publik në dy media televizive, njëri prej të cilëve është kombëtar dhe tjetri lokal. Pjesëmarrja e tij në këtë mbledhje është dokumentuar nëpërmjet një fotografie, e cila ka qarkulluar në mënyrë elektronike. Nga ky moment ka filluar edhe trajtimi i padrejtë dhe i pabarabartë i ankuesit për shkak të bindjes së tij politike.

Z. D.B. u shpreh se punësimi i tij është kryer nga IKMT Qendrore në Tiranë, institucion, i cili fillimisht nuk kishte dijeni mbi bindjen politike të ankuesit. Ky punësim ishte parë me çudi në Bulqizë/Dibër, ku bindja politike e djathtë e z. D.B. ishte e njohur.

I pyetur mbi mënyrën e rekrutimit të tij, ankuesi sqaroi se kur është vënë në dijeni për shpalljen vakant të pozicionit të inspektorit të IKMT-së në Dibër në muajin shkurt 2020, ai ka aplikuar *on line* duke dërguar kërkesën dhe dokumentacionin e kërkuar, duke kaluar fazën e parë të konkurrimit. Në kushtet e fillimit të pandemisë Covid 2019, ai sqaron se intervista me personat përgjegjës të IKMT-së është shtyrë, si pasojë e kufizimeve të lëvizjen e qytetarëve. Në vijim, në datën 20 maj 2020 është kryer intervista e punës pranë IKMT-së në Tiranë dhe ai ka fituar vendin e punës. Mungesa e informacionit mbi bindjet e tij politike dhe mungesa e kontaktit me subjektet përkatëse në Dibër, si pasojë e pandemisë, ka ndikuar pozitivisht në favor të tij, pasi ankuesi është emëruar në pozicionin e Inspektorit, në Sektorin e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujrave, në Drejtorinë Rajonale Dibër, të IKMT-së.

Z. D.B. sqaron se, në momentin e emërimit të tij e në vijim, për sa kohë ka zgjatur marrëdhënia e punës, nuk kishte ende një ambient në të cilin duhet të punonte, si dhe titullari i Drejtorisë Rajonale Dibër nuk ishte emëruar ende. Ai sqaroi se Drejtori i Drejtorisë Rajonale Dibër të IKMT-së është emëruar pas largimit të tij nga puna, si dhe detyrat që duhet të kryente i ngarkoheshin drejtpërdrejtë nga tre persona përgjegjës pranë IKMT Tiranë. Për kryerjen e detyrave të ngarkuara, ai sqaron se ka patur bashkëpunim të vazhdueshëm me Policinë e Shtetit, pasi detyrat që ai ushtronte konsistonin në kontrole për ndërtime pa leje etj. Ai sqaron se urdhërat për kryerjen e detyrave i komunikoheshin verbalisht nga IKMT Tiranë me telefon. Ankuesi thekson se vijoi të kryente detyrat e tij deri në datën 08.07.2020, fakt që vërtetohet nga akt-konstatimet e nënshkruara. Gjatë pjesëmarrjes së ankuesit në takimin e subjektit politik PD, pjesëmarrja e tij është fotografuar dhe ka qarkulluar ndërmjet kolegëve. Menjëherë, pas takimit, ai është larguar nga detyra.

I pyetur nga përfaqësuesit e KMD-së, nëse ka ndjerë apo përjetuar trajtim të diferencuar me të tjerët, gjatë kohës që ka punuar si inspektor i IKMT-së Dibër, për shkak të bindjes politike, ankuesi sqaroi se në takimin prezantues të IKMT-së Dibër është pyetur se cilit subjekt politik i përket, pasi figura e tij ishte e njohur si përfaqësues i Partisë Demokratike, Dega Dibër. Pas këtij takimi, ditën e shtunë, ankuesi sqaron se është kontaktuar nga z. B.D. për të shkuar nga Bulqiza në Burrel, për një kontroll. Z. D.B. u shpreh se fillimisht nuk ka pranuar, pasi i duhej të përballonte vetë shpenzimet për karburantin, por në kushtet kur urdhërohej nga IKMT Tiranë ka pranuar të punojë ditën e shtunë. Z. D.B. sqaron se ka kryer detyrën dhe akt konstatimin e ka dërguar tek personat përgjegjës pranë IKMT Tiranë. Duke qënë se ditën e shtunë ka qënë në detyrë, ditën e hënë e ka bërë pushim, pasi ka marrë paraprakisht konfirmimin në telefon e z. B.D.

Ndër të tjera, ankuesi u shpreh se një ditë para largimit nga puna, në datën 07.07.2021, në mbledhjen prezantuese të IKMT-së, është pyetur nga kryetari i PS Peshkopi, se si ka mundësi që është punësuar pranë këtij institucioni. Në datën 08.07.2021, ankuesi sqaron se është kontaktuar në telefon nga IKMT Tiranë, se i janë shkëputur marrëdhëniet e punës. Ankuesi thekson faktin se nuk ka patur dijeni mbi ndonjë vërejtje të dhënë nga eprorët, por e ka kuptuar që punësimi i tij nuk do të zgjaste shumë, pasi i ishte propozuar që të anëtarësohej në një subjekt tjetër politik dhe kishte refuzuar.

I pyetur nëse inspektorë të tjerë të IKMT Dibër janë larguar nga puna, ankuesi u shpreh se ata vazhdojnë ende të jenë në punë, përveç inspektorit A.K., i cili është larguar nga detyra në të njëjtën ditë me të. Ankuesi ka sqaruar gjithashtu se Zyra e IKMT-së Dibër është plotësuar me personel pas largimit të tij nga puna. I pyetur mbi faktin nëse ka inspektorë të tjerë të IKMT-së Bulqizë që janë emëruar njëkohësisht me të, ankuesi sqaron se janë punësuar edhe 3 punonjës të tjerë, të cilët ishin inspektorë mjedisi. Njëri prej tyre, që vinte nga Tirana, ishte larguar gjithashtu nga puna njëkohësisht me të.

I pyetur nga përfaqësuesit e KMD-së nëse aktualisht është në proces gjyqësor me IKMT, lidhur me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, përfaqësuesja ligjore e ankuesit u shpreh se akti i largimit nga puna është kundërshtuar gjyqësisht.

- Në vijim të seancës dëgjimore, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua sërsish Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, nëpërmjet shkresës nr. 1313/1 prot., datë 08.11.2021, ku i përcillet për dijeni procesverbali i seancës dëgjimore. Në shkresën e sipërcituar, si dhe mbështetur në thëniet e palës ankuese në seancë dëgjimore, KMD kërkoi të përcillej në cilësi prove, çdo informacion plotësues ose akt administrativ, i cili nuk ishte paraqitur ende dhe ishte kërkuar nga KMD, sikurse edhe çdo akt që vlerësohej se kishte rëndësi për përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave të çështjes.
- IKMT nuk dërgoi asnjë informacion vijues në adresë të KMD-së.
- Në vijim, KMD i dërgoi përfaqësueses së ankuesit e-mail, duke i kërkuar informacion mbi çështjet e mëposhtëme:
 1. Informacion nëse disponohet ndonjë akt i IKMT-së, ku të jenë evidentuar shkeljet e kryera nga z. D.B., mbi bazën e se cilit ai është liruar nga detyra;
 2. Informacion nëse në gjykatë, IKMT ka paraqitur prova dhe fakte që vërtetojnë, motivacionin e liritimit nga detyra te z. D.B.;
 3. Informacion mbi burimin e informacionit, në bazë të së cilit pretendohet se z. D.B. është larguar nga detyra, pasi nuk është paraqitur në punë në datën 29.06.2021? A ka qenë IKMT, që ia ka komunikuar një fakt të tillë ankuesit, qoftë edhe në mënyrë verbale?

- Në përgjigje të e-mailit të sipërcituar, përfaqësuesja ligjore e ankuesit ka dërguar informacion, duke e bërë me dije KMD-në se nga ana e IKMT nuk u është vënë në dispozicion asnjë akt, ku të jenë evidentuar shkeljet e kryera, si dhe asnjë informacion i tillë, ku të evidentohen arsyet e largimit nga puna, nuk i është vënë në dispozicion as gjykatës, nga ana e IKMT, përveç aktit të njoftimit të zgjidhjes së kontratës së punës, akt i cili ndodhet edhe ne dosjen e dorëzuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Përfaqësuesja ligjore e tij sqaron se D.B. nuk pretendon se është larguar për shkak se nuk është paraqitur në punë në datën 29.06.2021, që korrespondon me ditë pushimi. Ajo thekson faktin se kjo i është thënë nga kolegë dhe punonjës të lartë të bashkisë, (përfshirë edhe Kryetari i Bashkisë) se ky ka qenë preteksti i lirimit nga detyra. Personat e sipërcituar, gjithashtu i kanë referuar si shkak të largimit nga puna, faktin se ai është anëtar dhe madje aktiv i Partisë Demokratike. Lidhur me këtë pretendim, ajo sqaron se nuk ka asnjë provë, që ta vërtetojë.

I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.

Në bazë të Vendimit nr. 893, datë 4.11.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”, të ndryshuar⁶, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit është institucion qendror, buxhetor, person juridik, publik, në varësi të ministrit përgjegjës për ruajtjen dhe sigurinë e territorit dhe të ndërtimeve, si dhe për parandalimin, mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e peizazhit, të tokës, të ajrit, të ujërave dhe të pyjeve nga ndotja, dëmtimet apo ndërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji, me seli në Tiranë.

Mbështetur në pikën 2 të VKM-së së sipërcituar, misioni i Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit është kontrolli, mbrojtja e territorit dhe e peizazhit nga ndërhyrjet dhe zhvillimet e kundërligjshme, duke garantuar një zhvillim të qëndrueshëm e të sigurt në fushën e zhvillimit, të planifikimit, të mbrojtjes së territorit, të tokës, të ajrit, të ujërave dhe të pyjeve,

⁶ Ndryshuar me VKM nr. Nr. 513, datë 1.7.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 893, datë 4.11.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”;

të disiplinimit të punimeve në ndërtim, të produkteve të ndërtimit, si dhe në fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujore.

IKMT-ja organizohet në nivel qendror dhe në nivel rajonal, nëpërmjet 12 drejtorive rajonale, një prej së cilave është edhe Drejtoria Rajonale Dibër, e cila është krijuar në vitin 2020, nëpërmjet Urdhërit nr. 22, datë 03.02.2020, të Kryeministrit, *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”*. IKMT-ja, nëpërmjet kryeinspektorit dhe inspektorëve, ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e parashikuara në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, *“Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”*, të ndryshuar. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të IKMT-së rregullohen nga dispozitat e Kodit të Punës.

Sipas parashikimit të nenit 3, të Urdhërit nr. 424, datë 25.11.2020, të Ministrit të Brendshëm *“Për miratimin e Rregullores së Brendshme të funksionimit të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”* Drejtoritë Rajonale të IKMT-së janë të organizuara me një strukturë të njëjtë, e cila ka 1 (një) drejtor dhe 4 sektorë, të cilët janë Sektori i Inspektimit të Territorit, Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujrave, Sektori i Inspektimit Pyjor dhe Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Në referencë të pikës 17, të nenit 5, të kësaj Rregulloreje, Kryeinspektori emëron, liron, shkakon nga detyra drejtorët e drejtorive, përgjegjësit e sektorëve, si dhe të gjithë personelin punonjës në përbërje të strukturave administrative në qendër dhe në nivel rajonal.

Mbështetur në sa më sipër, nëpërmjet shkresës nr. 1837 prot., datë 15.06.2020, së Kryeinspektorit, z. D.B. është emëruar në detyrën e specialistit (inspektor) në Sektorin e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujrave, në Drejtorinë Rajonale Dibër, të IKMT-së dhe marrëdhëniet e punës janë rregulluar nëpërmjet kontratës individuale të punës me afat të caktuar (3 muaj), të lidhur ndërmjet palëve në datën 15.05.2020. Kohëzgjatja e kontratës shtrihej në datat 20.05.2020-20.08.2020. Në bazë të nenit 73 të Rregullores së sipërcituar, detyrat e pozicionit të punës specialist (inspektor) i Sektorit të Inspektimit të Mjedisit dhe Ujrave, të Drejtorisë Rajonale Dibër, përfshijnë përveç detyrave të përgjithshme funksionale, në përshtatje me kushtet specifike të punës në terren edhe disa detyra të veçanta, të cilat konsistojnë në: 1) punën në vijimësi për përditësimin e informacionit mbi situatën mjedisore, si dhe njohjen e detajuar të shtrirjes gjeografike të territorit që mbulon, 2) zbaton me përpikmëri grafikët e miratuar, apo urdhërat e veçantë të eprorit kompetent për kontrollin dhe mbikqyrjen sistematike të territorit, 3) përgjigjet drejtpërdrejtë për zbatimin e ligjshmërisë dhe respektimin e etikës zyrtare dhe korrektesës në marrëdhënie me subjektet që i nënshtrohen procedurave të kontrollit dhe inspektimit, 4) përgjigjet drejtpërdrejtë për zbatimin e ligjshmërisë, evidentimin dhe plotësimin korrekt të formularëve që dokumentojnë ushtrimin e

përgjegjësiive proceduriale të kontrollit të inspektimit, si dhe bashkërendon punën me përgjegjësin e sektorit për përmbushjen e detyrave dhe objektivave të mësipërm.

Për sa më sipër, në mungesë të drejtorit të Drejtorisë Rajonale Dibër, ankuesi ka sqaruar se detyrat dhe urdhërat përkatës i merrte nga IKMT Tiranë, me telefon, ndërkohë që në kushtet kur, Drejtoria Rajonale Dibër ishte një drejtori e krijuar rishtazi në vitin 2020, ende nuk ishin siguruar ambientet për funksionimin e saj.

Pa përfunduar ende afati 3 mujor i kontratës individuale të punës, nëpërmjet Urdhërit nr. 2971 prot., datë 08.07.2020, të Kryeinspektorit, ankuesi lirohet nga detyra për moskryerje të detyrave, pa shkaqe të arsyeshme. Nga dokumentacioni i administruar në cilësi prove nga të dyja palët, Komisioneri ka konstatuar se shkeljet e këtij punonjësi nuk janë të dokumentuara në asnjë akt të IKMT-së. Në korrespondencën zyrtare me KMD, IKMT nuk i ka bërë të ditura Komisionerit se cilat janë këto shkelje që ka kryer z. D.B. dhe cilat janë faktet dhe provat që vërtetojnë këto shkelje të tij, edhe pse të gjitha këto janë kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri.

Përveç sa më sipër, KMD ka konstatuar se lirimi nga detyra i ankuesit nga ana e Kryeinspektorit është kryer në mënyrë të menjëherëshme dhe pa zbatuar asnjë nga procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të IKMT-së. Referuar nenit 87 të kësaj Rregulloreje parashikohet se: *“Konsiderohen shkelje disiplinore: a) mosrespektimi i përsëritur dhe pa shkaqe të justifikuara të orarit të punës dhe kohës së punës; b) mungesa në punë pa shkaqe të arsyeshme dhe pa njoftuar eprorin; c) moskryerja e detyrave pa shkak të arsyeshëm ose brenda afateve të caktuara nga eprori; d) dëmtimi i pasurisë së institucionit, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar dhe krijimi pa shkaqe të pranueshme i mundësisë për dëmtim apo keqpërdorim të saj. Përgjegjësia disiplinore e punonjësit sipas kësaj pike nuk përjashton përgjegjësinë e tij material për zhdëmtimin e dëmit pasuror të shkaktuar; e) shkelja e rregullave të etikës nga punonjësit; si dhe f) moszbatimi i dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale.”*

Sipas nenit 88/1, të Rregullores së Brendshme të IKMT-së, parashikohet se:

“1. Në zbatim dhe për efekt të kësaj rregulloreje do të konsiderohen masa disiplinore:

- b) Tërheqje vëmendjeje, e cila i komunikohet punonjësit në formë shkresore, verbalisht ose nëpërmjet postës elektronike;*
- c) Vërejtje me shkrim deri në 6 muaj;*
- d) Paralajmërim me shkrim për largim nga puna deri në 1 vit*
- e) Largimi nga puna.”*

Në bazë të pikës 4 të së njëjtit nen parashikohet se: *“Në caktimin e masave disiplinore nuk ndiqet rradhë nga masa më e lehtë në masën më të rëndë, megjithatë duhet të zbatohet parimi që masa e shkeljes të jetë në proporcion me llojin e shkeljes, duke zbatuar parimin e proporcionalitetit”.*

Kjo Rregullore parashikon një procedurë të posaçme për dhënien e masave disiplinore, e cila fillon me propozimin përkatës drejtuar titullarit të institucionit nga eprori i drejtpërdrejtë i punonjësit, si dhe nga çdo organ, njësi administrative apo person tjetër i interesuar. Në dokumentacionin e depozituar nga IKMT Tiranë rezulton se nuk ka asnjë propozim të tillë nga ish-punonjësit të Drejtorisë Rajonale Dibër, z. D.B..

Në vijim, referuar pikës 2 të nenit 89, të Rregullores së sipërcituar rezulton se titullari i institucionit, pra kryeinspektori i IKMT-së, brenda 3 ditëve nga marrja e njoftimit, shqyrton rrethanat e çështjes, duke vepruar si më poshtë:

- Dëgjon propozuesin në lidhje me faktet dhe arsyet në të cilat mbështetet propozimi;
- Dëgjon punonjësën ndaj së cilit propozohet caktimi i masës disiplinore;
- Dëgjon punonjësit, të cilët mund të kenë dijeni për çështjen;
- Grumbullon të dhënat e mjaftueshme, të cilat vërtetojnë ekzistencën e fakteve që pretendohet se përbëjnë shkelje disiplinore.

Vetëm pas kryerjes së procesit të sipërpërmendur, titullari i institucionit shprehet për pranimin ose jo të masës disiplinore ndaj punonjësit. Parashikimet e mësipërme vlejné si për punonjësit me kontratë me afat të pacaktuar pune, ashtu sikurse edhe për punonjësit që punojné me kontratë me afat të caktuar pune.

Sërish, mbështetur në dokumentacionin e depozituar nga IKMT Tiranë, KMD ka konstatuar se një procedurë e tillë nuk është ndjekur ndaj z. D.B., i cili është liruar nga detyra në mënyrë të menjëherëshme dhe duke i mohuar të drejtën për t’u dëgjuar dhe për të parashtruar observacionet e tij, lidhur me shkeljet që IKMT kishte konstatuar. Sikurse është përmendur edhe më sipër, shkeljet e z. D.B. nuk rezultojné të evidentuara dhe të dokumentuara në asnjë akt administrativ të IKMT-së Tiranë.

Në pikat 1 dhe 2 të nenit 153 të Kodit të Punës parashikohet shprehimisht:

1. *“Punëdhënësi e punëmarrësi, në cdo kohë, mund të zgjidhin menjëherë kontratën për shkaqe të justifikuara.*

2. *Vlerësohen si shkaqe të justifikuara të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, t'i kërkohet atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënieve të punës.*
3. *Gjykata vendos nëse ekzistojnë shkaqe të justifikuara për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës. Konsiderohen shkaqe të justifikuara rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, si edhe rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit.”*

Për sa më sipër, KMD gjykon se në interpretim të dispozitës në fjalë, përcaktohen se dy janë kushtet kryesore dhe kumulative, që duhen plotësuar në mënyrë që zgjidhja e menjëherëshme e kontratës së punës të jetë e rregullt dhe e justifikuar. Së pari, kushti subjektiv që lidhet me qendrimin subjektiv, shkeljen e raportit të mirëbesimit ndaj punëdhënësit, por që në çdo rast duhet që rrethana të jetë abuzive dhe së dyti, kushti objektiv, ku punëmarrësi duhet të ketë kryer një shkelje me faj të rëndë ose të lehtë, në mënyrë të përsëritur dhe gjithmonë pas një lajmërimi përkatës, si dhe të ketë një lidhje shkakësore ndërmjet shkeljes së kryer dhe zgjidhjes së menjëherëshme të kontratës dhe shkelja të ketë cënuar raportin e mirëbesimit midis palëve.

Për sa më sipër, KMD ka konstatuar se “shkaqet e justifikuara” nuk janë të dokumentuara nga ana e IKMT në nivel qendror, në asnjë akt administrativ të këtij institucioni.

Z. D.B. ka theksuar faktin se është njoftuar me telefon nga personat përgjegjës së IKMT-së Tiranë mbi lirimin nga detyra dhe në vijim i ka mbërritur urdhëri i Kryeinspektorit. Ankuesi pretendon se nuk i janë bërë të ditura se cilat janë shkeljet e kryera, për të cilat është liruar nga detyra, por beson se mosparaqitja e tij në punë në datën 29.06.2020, ditën e hënë, që përkon me ditë pushimi, pasi ka dalë në punë ditën e shtunë, ka qenë shkak ose pretekst për një gjë të tillë. Në të njëjtën kohë justifikon faktin se ka punuar ditën e shtunë, datë 27/06/2020, në bazë të një urdhëri verbal të personave përgjegjës nga IKMT Tiranë dhe në cilësi prove, ai ka paraqitur Akt-konstatimin përkatës, që ai ka punuar në këtë datë. Një deklaram të tillë, ai e mbështet në burime jo zyrtare, pasi IKMT në asnjë rast nuk ka evidentuar dhe provuar se një fakt i tillë është marrë për bazë të lirimit nga detyra të ankuesit. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se për sa kohë që IKMT në nivel qendror nuk ka të dokumentuar asnjë shkelje të tij në një akt të mirëfilltë administrativ, supozimi i ankuesit se është liruar nga detyra me pretekstin e mungesës së kryer në punë, nuk mund të merret si e bazuar.

IKMT ka sqaruar se ka liruar nga detyra edhe dy punonjës të tjerë të Drejtorisë Rajonale Dibër, përkatësisht z. D.K. dhe z. R.K., por nuk ka dërguar në cilësi prove aktet e lirimit nga

detyra dhe nuk ka dhënë informacion as për motivacionin e zgjidhjes së kontratës së tyre të punës, për të cilin është kërkuar specifikisht informacion nga ana e KMD-së.

Nga analiza e fakteve të sipërpërmendura, KMD gjykon se IKMT në nivel qendror e ka liruar ankuesin pa asnjë shkak të arsyeshëm, duke e ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë dhe disfavorizues.

B. Shkaku i mbrojtur “bindja politike”.

Z. D.B. pretendon diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”, nga ana e IKMT Tiranë.

“*Bindja politike*” është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”, Komisioneri gjykon se “*bindja politike*” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur. Ankuesi ka depozituar gjithashtu në cilësi prove kopje të Kartës së Anëtarësimit me nr. personal 190/210091, datë 24.04.2017, lëshuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, ku rezulton se z. D.B. është anëtar i Partisë Demokratike, si dhe foto nga një mbledhje e Kryesisë së Degës së Partisë Demokratike Bulqizë, ku prezantohet udhëzimi i PDSH, për përzgjedhjen e kandidatëve për zgjedhjet e ardhshme parlamentare.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur – bindja politike.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezultoi se z. D.B. i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e IKMT në nivel qendror.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore, që i garantohet individit lidhur me shkakun e bindjes politike, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar.

Për sa më sipër, parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit parashikohet nga Kushtetura e Republikës së Shqipërisë, si dhe nga akte të tjera ligjore, duke sanksionuar njëkohësisht edhe zbatimin e tij nga të gjithë shtetasit shqiptarë. Referuar nenit 49, të Kushtetutës së Republikës parashikohet: *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*. Në këtë sens, kjo dispozitë i garanton çdo individ të drejtën për punë. Neni 18, pika 2, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon shprehimisht: *“Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.”*

Njëkohësisht, në referencë të nenit 14, të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut garantohet barazia e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, sikurse edhe në Kartën Social Europiane (të rishikuar) dhe Shtojcën e saj përkatësisht në nenin 24, pika 3, gërma d) parashikohet shprehimisht: *“...Nuk do të përbëjnë arsye të vlefshme për përfundimin e punësimit....d) raca, ngjyra, gjinia, gjendja familjare përgjegjësitë familjare, shtatëzania, besimi fetar, opinion politik, prejardhja kombëtare ose origjina sociale”*.

Referuar Vendimit të GJEDNJ⁷, për çështjen *Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar* (2012), duke u mbështetur në parimin e nenit 11, të KEDNJ-së, që partitë politike janë thelbësore për funksionimin e duhur të demokracisë, Gjykata konsideron: *“Duke pasur parasysh rëndësinë e demokracisë në sistemin e Konventave, Gjykata konsideron se në mungesë të masave mbrojtëse gjyqësore një sistem juridik, i cili lejon largimin nga puna vetëm për shkak të anëtarësisht të punonjësve në një parti politike mbart me vete mundësinë e abuzimit”* (paragrafi 55).

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion barazie i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi, në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për: *“a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”*.

Në nenin 12, pika 1, gërma (c), të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, parashikohet se: *“1.Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e*

⁷ Redfearn v. The United Kingdom: ECHR 6 Nov 2012;

përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;”

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Neni 9, pikat 9 & 10, të Kodit të Punës parashikojnë shprehimisht: “9. Në rastin kur një person pretendon se është cënuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, sipas këtij Kodi, ndiqet procedura e ankimit, e përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. 10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë.”

Kodi i Procedurës Administrative⁸ ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast IKMT, e cila duhet të provojë se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

LMD, i ndryshuar, ka saktësuar gjithashtu se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast IKMT, që duhet të provojë se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një qendrimit të padrejtë dhe disfavorizues për shkak të bindjes së tij, politike.

⁸ Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Kështu, neni 33, pika 7/1 i LMD, të ndryshuar, përcakton se: “Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”

Parimi i ndarjes së barrës së provës është një parim i mirënjohur tashmë në legjislacionin e BE-së dhe KEDNJ. KEDS⁹ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të duhur.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë **se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues**.

Kjo mund të realizohet në njërin nga dy mënyrat e mëposhtme:

1. Duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë ose,
2. Duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ekziston një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti kundër së cilit drejtohet ankesa nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.¹⁰

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkakun i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet, kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave.....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i*

⁹ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

¹⁰ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht¹¹”.

Në lidhje me rastin në fjalë, mbështetur në analizimin e fakteve dhe provave të depozituara nga ankuesi, si dhe në bazë të rezultateve që dolën nga procedura e shqyrtimit të ankesës, Komisioneri ka vlerësuar se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankuesit nga ana e IKMT, pasi atij i është zgjidhur kontrata e punës me afat të caktuar, para plotësimit të këtij afati, pa motivacion të provuar. Ankuesi është liruar nga detyra në mënyrë të menjëherëshme dhe duke i mohuar të drejtën për t’u dëgjuar dhe për të parashtruar observacionet e tij, lidhur me shkeljet që IKMT pretendon se ai ka kryer. Sikurse është përmendur edhe më sipër, shkeljet e z. D.B. nuk rezultojnë të evidentuara dhe të dokumentuara në asnjë akt administrativ të IKMT-së Tiranë.

Përsa i përket bindjeve politike të ankuesit, mbështetur në dokumentacionin e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe specifikisht referuar Kartës së Anëtarësimit me nr. personal 190/210091, datë 24.04.2017, lëshuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, rezulton se ankuesi është anëtar i Partisë Demokratike. Njëkohësisht, referuar fotos së dërguar në cilësi prove nga ankuesi, të një mbledhjeje të Kryesisë së Degës së Partisë Demokratikë Bulqizë, të zhvilluar në datën 30.06.2020, ku prezantohet udhëzimi i PDSH për përzgjedhjen e kandidatëve për zgjedhjet e ardhshme, rezulton se ai është pjesëmarrës në të¹². Në këtë kontekst, KMD ka krijuar dyshimin e arsyeshem që lirimi i tij nga detyra ka motive të ndryshme nga ato të përcaktuara në urdhërin e lirimit nga detyra dhe IKMT në cilësinë e subjektit që ka barrën e provës i takon të vërtetojë të kundërtën.

Për sa më sipër, Komisioneri çmon se fillimisht IKMT në nivel qendror nuk ka patur dijeni mbi bindjet politike, të dhathta të ankuesit dhe ka kryer emërimin e tij në pozicionin e specialistit (inspektor) në Sektorin e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave, në Drejtorinë Rajonale Dibër, të IKMT-së. Në datën 30.06.2020, ankuesi ka marrë pjesë në mbledhjen e kryesisë së subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë. Kjo mbledhje është pasqyruar në median televizive lokale dhe në një televizion kombëtar. Vetëm 8 ditë pas kësaj mbledhjeje, ankuesi është liruar nga detyra, nëpërmjet Urdhërit nr. 2971 prot., datë 08.07.2020, të Kryeinspektorit, me motivacion *“moskryerje e detyrave pa shkaqe të arsyeshme”*. Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se në kushtet kur Bulqiza, që është edhe vendbanimi i ankuesit

¹¹ GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

¹² Për më shumë informacion referohu tek linku <https://youtu.be/OxhlvjFuLlg>

është një qytet i vogël¹³, me numër të vogël banorësh¹⁴, është mëse e kuptueshme që bindjet politike të ankuesit të jenë të njohura nga banorët e tjerë, aq më tepër kur aktiviteti politik i z. D.B. është bërë evident edhe në mediat televizive. Përcjellja e informacionit mbi këto bindje politike pranë IKMT-së në nivel qendror, ka ndikuar në marrëdhënien e punësimit të z. D.B.. Nga dokumentacioni i administruar në cilësi prove nga të dyja palët, Komisioneri ka konstatuar se shkeljet e këtij punonjësi dhe “shkaqet e arsyeshme” që janë cituar si motivacion i lirimit të tij nga detyra nuk janë të dokumentuara në asnjë akt zyrtar të IKMT-së.

Në korrespondecën zyrtare me KMD, IKMT nuk i ka bërë të ditura Komisionerit se cilat janë këto shkelje që ka kryer z. D.B. dhe cilat janë provat që vërtetojnë këto shkelje të tij, edhe pse të gjitha këto fakte janë kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri. Përveç sa më sipër, KMD ka konstatuar se lirimi nga detyra i ankuesit nga ana e Kryeinspektorit është kryer në mënyrë të menjëherëshme dhe pa zbatuar asnjë nga procedurat e përcaktuara në nenin 89 të Rregullores së Brendshme të IKMT-së, ndërkohë që “shkaqet e arsyeshme” nuk janë të dukshme dhe të arsyetuara. Në këtë kontekst, KMD gjykon se edhe nëse ankuesi do të kishte kryer shkelje, në vënien e masës disiplinore ndaj tij duhej zbatuar parimi i proporcionalitetit dhe jo të veprimeve me masën ekstreme të lirimit nga detyra. IKMT ka sqaruar se ka liruar nga detyra edhe dy punonjës të tjerë të Drejtorisë Rajonale Dibër, përkastësisht z. D.K. dhe z. R.K., por nuk ka dërguar në cilësi prove aktet e lirimit nga detyra dhe nuk ka dhënë informacion as për motivacionin e zgjidhjes së kontratës së tyre të punës.

Mbështetur në konstatimet dhe vlerësimet e sipërcituara, Komisioneri gjykon se procedura e ndjekur për zgjidhjen e kontratës së punës nuk motivohet nga shkaqe të arsyeshme, të provuara dhe faktike. Njëkohësisht duke iu referuar faktit se ankuesi është anëtar i Partisë Demokratike, si dhe duke patur parasysh se IKMT, që është edhe subjekti që ka barrën e provës në këtë proces administrativ, në asnjë rast, nuk ka arritur të provojë se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë apo të justifikojë se ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, por ekziston një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv, Komisioneri del në përfundimin se zgjidhja e kontratës së punës së z. D.B. është kryer për motive politike.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se z. D.B. është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm për shkak të bindjes politike, nga ana e IKMT.

¹³ Sipërfaqja e qytetit të Bulqizës është 678.51 km²

¹⁴ Numri i banorëve është 40.223;

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pikat 1 dhe 3, nenit 12, nenit 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-12, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të z. D.B., për shkak të bindjes politike, nga nga ana e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkak – bindja politike
Fusha – punësim
Lloji i vendimit - diskriminim